# DËSHMI ARKIVI

**A-452762**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pagat e gjyqtarëve/ Shoqata Evropiane kundërshton projektligjin: Po anashkalohet vendimi i Kushtetues es |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/pagat-e-gjyqtareve-shoqata-evropiane-kundershton-projektligj in-po-ana-i514675` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 15:36:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 15:22:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fdea896510feb1ef02e1f5ec26d54d945f7fba622d6c306920dada87490ecbe6` |
| TEKSTI | `b1a89c4d62326ce42d646e7daaa2e4ebad49f513d51f32c8b60decc5b43d1cd8` |
| PAMJA | `20679bf927e5975473f8e8e1ba48f4b444ac6974a5f450d0e4d159fe1e12c4bd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7edd62ff69a34d6f277279a59e1da7fab7621ab5de17695320a6d5804114e22d` |
| E MËPARSHMJA | `94135dbb67fd791d9d1521930eba9c9f0a7022c03c7229bc36c7173e4f0f05db` |
| RRËNJA MERKLE | `a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7edd62ff69a34d6f277279a59e1da7fab7621ab5de17695320a6d5804114e22d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Pagat e gjyqtarëve/ Shoqata Evropiane kundërshton projektligjin: Po anashkalohet vendimi i Kushtetueses

Shoqata thekson se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për institucionet publike dhe duhet të zbatohen plotësisht.

dosja
17 Shtator 2026, 17:22
Nga G.M



foto ilustruese

**TIRANË**- Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve (EAJ) ka reaguar lidhur me debatet për pagat e gjyqtarëve, duke shprehur shqetësim për projektligjin e paraqitur në Kuvend. Sipas saj, kjo nismë parashikon rillogaritjen retroaktive të pagave dhe nuk është në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Shoqata thekson se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për institucionet publike dhe duhet të zbatohen plotësisht. Ajo paralajmëroi se moszbatimi i vendimit mund të ndikojë në shtetin e së drejtës, pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve.

Bordi i EAJ-së ka tjhëë se shpreson, që regresi i propozuar të mund të parandalohet. Ajo ka bërë të ditur se do ta diskutojë çështjen në Asamblenë e Përgjithshme në Lisbonë dhe do të informojë edhe institucionet ndërkombëtare.

**Reagimi i plotë:**

*Shoqata Europiane e Gjyqtarëve*

*Bordi i Shoqatës Europiane të Gjyqtarëve, EAJ, shpreh shqetësimin e tij të thellë lidhur me zhvillimet në Shqipëri. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj 15/2026, shpalli antikushtetues sistemin ekzistues të pagave për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin tjetër të gjykatave, dhe urdhëroi ligjvënësin të ndryshonte dispozitat përkatëse në përputhje me udhëzimet e saj brenda një afati të caktuar. Ajo gjithashtu përcakton se cilat dispozita duhet të zbatohen në rast se ligjvënësi nuk vepron. Jo vetëm që këto udhëzime u shpërfillën dhe pagesa e shumës së përcaktuar nga gjykata u refuzua, por në Parlament u paraqit madje një projektligj që parashikonte një rillogaritje*

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 17:03
Dënimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Protesta edhe në SHBA, shqiptarët nga Times Square këndojnë "Mora fjalë" (VIDEO)

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:46
"Urime për look-un e ri"/ Muçi ironizon deputeten socialiste, Zegjine Çaushi i përgjigjet ashpër: O psikopat, na hape barkun

*përcaktuar nga gjykata u refuzua, por në Parlament u paraqit madje një projektligj, që parashikonte një llogaritje prapavepruese të shpërblimit në fjalë.*

*Nëse ky projektligj do të miratohej, ai jo vetëm do të shfuqizonte rregullimin që rrjedh drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, por do të fuste gjithashtu në mënyrë prapavepruese një metodë llogaritjeje që duket po aq problematike sa ajo që gjykata e gjeti antikushtetuese. Me pak fjalë, ligjvënësi po përpiqet të anashkalojë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.*

*Zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore, që buron nga natyra e tyre detyruese, është një element themelor i shtetit të së drejtës. Vetë koncepti i një gjykate të pavarur, i përcaktuar në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, nënkupton se një gjykatë ka autoritetin të japë një vendim detyrues që nuk i nënshtrohet ndryshimit, miratimit apo ratifikimit nga ndonjë autoritet jogjyqësor.*

*Sa i përket posaçërisht zbatimit të vendimeve të gjykatave kushtetuese, natyra e tyre përfundimtare dhe detyruese rrjedh domosdoshmërisht nga epërsia e Kushtetutës. Këto vendime duhet të respektohen nga të gjitha autoritetet publike dhe individët. Moszbatimi i një vendimi të gjykatës kushtetuese është i barasvlershëm me shkeljen e vetë Kushtetutës.*

*Nga ky këndvështrim, zhvillimet e përmendura më sipër shkelin shtetin e së drejtës, pavarësinë e gjyqësorit dhe balancën e pushteteve. Ato gjithashtu minojnë besimin te shteti dhe te reformat pozitive të sistemit gjyqësor në Shqipëri, të cilat deri më tani janë arritur me përpjekje të mëdha.*

*Bordi i EAJ-së shpreson, për këtë arsye, që ky regres i propozuar të mund të parandalohet. Ai do të mbështesë anëtarin e tij, Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë, në përpjekjet e tij për të arritur këtë qëllim, do ta vendosë çështjen në rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme, e cila do të zhvillohet në tetor në Lisbonë, dhe do të informojë aktorët përkatës ndërkombëtarë dhe europianë për situatën alarmante në Shqipëri.*/**Dosja.al**

shoqata evropiane e gjyqtarëve | gjykata kushtetuese

## Sondazh

Poll

Aktualitet

17 Shtator 2026, 17:13

## Vendimi i Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Grenell publikon foton e Bleona Qeretit me mbishkrimin 'I love Hashim Thaçi'

TIRANË- Pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Richard Grenell ka reaguar në...

**Dënimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Protesta edhe në SHBA, shqiptarët nga Times Square këndojnë "Mora fjalë"**

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:22

Me cigare në dorë/ Monika Kryemadhi bashkëbisedon me protestuesit para SPAK: Bashkohuni dhe organizohuni mes jush!

## më të klikuarat

**Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)**

**Regjistruan 1143 hektarë me dokumente fals/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)**

**Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona**

**VIDEO e rëndë, familjarët i afrohen shoferit dhe… çastet tronditëse të aksidentimit fatal të kalimtarit**

## insights

Auron Janku

**Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë**

Ola Xama

**Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen**

Idriz Konjari

**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**

Bledian Koka

**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**

## Moti

Powered by tomorrow.io

(VIDEO)

Aktualitet

17 Shtator 2026, 17:03

### Analiza: Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës

Aktualitet

17 Shtator 2026, 17:07

### Vendimi ndaj Hashim Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë/ Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protestë: Qëndrimi ynë nuk ndryshon

Aktualitet

17 Shtator 2026, 15:48

### Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Aktualitet

17 Shtator 2026, 15:08

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:45

## Haga dënoi me 81 vite burg në total ish-krerët e UÇK-së/ Studentët në Prishtinë nisin protestat, kërkojnë drejtësi: MARRE

Pamje PRISHTINA- Dhjetëra studentë janë grumbulluar në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë ditën e sotme,...

### Grabitën me dhunë dy pika karburanti në Bulqizë, identifikohet njëri prej autorëve dhe shpallet në kërkim një tjetër

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:35

### Pjesë e objektit të EULEX-it përfshihet nga zjarri në protestën kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:30

### Haga dënoi Kosovën/ Mark Ellis: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:19

### RTSH hap një kapitull të ri: Identitet i ri vizual, programe të reja dhe pesë superprodhime në sezonin e ri

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:11

## MË SHUMË





"E qepi gojën"! Berisha për Ramën pas vendimit të Hagës: I futi thikën pas shpine Kosovës


"KAYO skandal i paparë"/ Berisha: Bëhet trafik armësh, e shëmtuar për një vend të NATO-s


Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së/ Spiropali: UÇK u ngrit për të mbrojtur gratë e dhunuara


Balla akuzon Berishën: Takove rusin që hartoi raportin kundër UÇK-së, punove kundër Hashim Thaçit

## "E qepi gojën"! Berisha për Ramën pas vendimit të Hagës: I futi thikën pas shpine Kosovës

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.